



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

Vazhdon bashkëpunimi i mirë midis Inspektoratit Policor të Kosovës dhe KMDLNj

Më 13 prill 2017, KMDLNj vizitoi Inspektoratin e Policisë së Kosovës dhe u takua me z. Hilmi Mehmeti kryeshef i IPK dhe znj. Miradie Kelmendi, udhëheqëse e Departmentit për Menaxhimin e Ankesave në kuadër të vazhimit të bashkëpunimit midis dy institucioneve që kanë mandat të monitorojnë punën e Policisë së Kosovës.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut i përcjellë informatat IPK –së, shqetësimet e qytetarëve në rast se Policia e Kosovës i tejkalon autorizimet e përcaktuara me ligj duke kërkuar hetimet e rasteve të tilla. Inspektorati Policor i Kosovës këto raste i trajton me seriozitet dhe nuk ndodhë që KMDLNj të mos informohet për masat që ndërmerr IPK, nga ato më të lehta deri te kallzimi penal për rastet më të rënda. Inspektorati Policor i Kosovës ndonëse nuk ka kushte të mira për punë, ka rezultate të mira dhe dita – ditës po konsolidohet, duke e ngritur kriterin e profesionalizmit që është parakusht kryesor për një punë të suksesshme.

Edhe me heret KMDLNj ka kërkuar që të përmirësohen kushtet e punës për Inspektoratin Policor të Kosovës, si ato fizike ashtu edhe materiale.

Inspektorati Policor i Kosovës është në një lokacion (Hajvali) që është vështirë i qasshëm për qytetarët që duan t'i paraqesin ankesat e tyre sikur që i kufizon aktivitetet monitoruese të inspektorëve të këtij inspektorati shkak se për çdo aktivitet duhet të përdoret vetura.

KMDLNj, më herët në takim me ministrin e Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni dhe drejtorin e Policisë, z. Shpend Maxhuni ka kërkuar që me urgjencë të ndahet një lokacion në qendër të qytetit për të krijuar mundësi që qytetarët t'i adresojnë shqetësimet e tyre sikur që edhe IPK të jetë më afër qytetarëve dhe Policisë së Kosovës. Si zgjidhje kalimtare KMDLNj pati propozuar që të jetë një zyre në qytet e IPK –së e hapur 24 orë për qytetarët deri sa të bëhet një zgjidhje përfundimtare. Përgjegjësit e MPB dhe PK kanë premtuar se do të angazhohen që kjo çështje të zgjidhet me urgjencë.

KMDLNj edhe në të ardhmën do të bashkëpunojë me IPK dhe kërkon nga qytetarët t'i paraqesin rastet në rast se ndaj tyre bëhet padrejtësi kur policia i tejkalon autorizimet zyrtare.

13 prill 2017

Shërbimi për Informim